



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 24.2.2025 Datë  
Nr. 1076/3 prot

FTESË PËR NEGOCIATË  
PËR  
AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR PRODHIM  
E VIDEOVE/SPOTE EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE, NË  
KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR KUVEND 2025.

Në zbatim të urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) nr. 125, datë 21.02.2025, "Prodhimin e spoteve në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza II" për zgjedhjet për Kuvend 2025, bazuar në vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, "Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për transmetim nga operatorët audiovizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore" të Këshillit të Ministrave, marrëveshjes me nr. 1893 prot, datë 24.03.2023, "Mbështetje e Parlamentit dhe edukimit qytetar, Mbështetje për KQZ-në", të lidhur me qeverinë Zviceriane, vendimin nr. 214 datë 20.12.2024, "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimin nr.206, 207 dhe 208 të datës 11.12.2024, "Për miratimin e Programit për Edukimin, Informimin dhe Ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimin nr.47 datë 22.01.2025, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025", të Këshillit të Ministrave, si dhe urdhrit të delegimit të detyrave me nr. 6 datë 09.01.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar.

**OBJEKTI**

Realizimin e prodhimit të spoteve televizivë dhe tutorialeve për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, për zgjedhësit brenda dhe jashtë vendit.

- 1. Ftesa për negociata për : Prodhim i spoteve/videove në kuadër të edukimit informimit ndërgjegjësimit të zgjedhësve Faza II**



#### **A- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, nr.4

Tel/Fax: +355 4 4510810

E-mail: [ermina.allushi@kqz.gov.al](mailto:ermina.allushi@kqz.gov.al)

Adresa e Internetit: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

KQZ do të zhvillojë procedurën e prodhimit të spoteve televizivë dhe tutorialeve për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, për zgjedhësit brenda dhe jashtë vendit, faza II.

**B- Periudha e realizimit të shërbimit:** nga data e nënshkrimit të kontratës deri në maj.

**C- Fondi limit i përcaktuar:** fondi limit i procedurës është në vlerën është 11,500,000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa Tvsh.

**D- Data e zhvillimit dhe pranimit përfundimtar të ofertave dhe dokumentacionit** do të jete 26.02.2025 ora 16:00.

*Shënim: Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarfjo transparent, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni.*

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj dhe dokumentacionin përkatës për këtë objekt me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

#### **E- Shërbimet që kërkohen të realizohen:**

**Përshkrimi i shërbimit është:** Realizimin e prodhimit të spoteve televizivë dhe tutorialeve për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, për zgjedhësit brenda dhe jashtë vendit, me qëllimin për tu ardhur në ndihmë zgjedhësve, që të informohen për hapat e procesit zgjedhor. Videot dhe imazhet informuese, duhet të përmbajnë në fokus informacion të plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 11 Maj 2025 për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Spot që do të realizohen janë:

1. Spot TV edukim/sensibilizim /informim për punonjësit shtetëror në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore si dhe titra televizive në gjuhë e minoriteteve edhe në gjuhën shqipe.
2. Spot TV edukim/sensibilizim për veprimet e zgjedhësit në QV "Hapat për të votuar" si dhe titra televizive në gjuhë e minoriteteve edhe në gjuhën shqipe.
3. Spot TV edukim/sensibilizim /informim si votohet nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) si dhe titra televizive në gjuhë e minoriteteve edhe në gjuhën shqipe.
4. Spot TV edukim/sensibilizim /informim "Plotësimi korrekt i fletës së votimit" për zgjedhësit brenda vendit si dhe titra televizive në gjuhë e minoriteteve edhe në gjuhën shqipe.
5. Spot TV edukim/sensibilizim /informim "Plotësimi korrekt i fletës së votimit" për zgjedhësit jashtë vendit.



Të gjitha spotet do të realizohen edhe në formatet baner për web, gif dhe popup të madhësive të ndryshme sipas standarteve të televizioneve të kontraktuara nga KQZ për transmetimin e fushatës në web-et e këtyre televizioneve.

Prodhim tutorialeve që do të realizohen janë:

1. Tutoriali i përdorimit të platformës së regjistrimit të zgjedhësve jashtë vendit (PER)
2. Tutorial për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI)
3. Tutorial për përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik (PEVN)
4. Tutorial për përdorimin e platformës elektronike të partive politike dhe subjekteve zgjedhore (PEP)
5. Tutorial për përdorimin e platformës elektronike të raportimit financiar (PERF)

Spotet duhet të prodhohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve. Cilësia e transmetimit duhet të jetë e përshtatshme për formatin e transmetimit Full HD.

Karakteristikat:

- Gjatësia mesatarisht 45 - 60 sekonda.
- Cilësia full HD.
- Kualiteti 4K.
- Voice Over Profesional.
- Video informuese informuese do të jenë të shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor.
- Videot të jenë të përshtatura në gjuhën e shenjave.
- Operatori duhet të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, materialet e përgatitura në CD ose usb në format të editueshëm dhe në formatin HD.

**F- Për realizimin e këtij shërbimi Autoriteti Kontraktor kërkon nga operatorët ekonomik dokumentacionin përkatës si më poshtë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. Është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
2. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. Nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
4. Personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
5. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;



6. Nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
7. Nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
8. Ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
9. Kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
10. Sigurim i kontratës me 10% të vlerës së ofertuar.

*Shënim: Për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund ti paraqesim më vetdeklarim dhe përpara fazës së shpalljes së fituesit përfundimtar, shoqëria e renditur e para më pikë do të sjellë dokumentacionin provues.*

**G- Kriteret e vlersimit sipas pikëve:**

Vlersimi i ofertës ekonomike me të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme: 20 pikë**
- **Kapacitet teknik dhe profesional 30 pikë**
- **Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizmin e kontratës 50 pikë**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monedhën lekë.

Kjo ftesë për negociatë do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) si dhe do ju dërgohet edhe me postë zyrtare operatorëve.

**Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociatë.**

**Sekretar i Përgjithshëm**

**Majlinda ÇELMETA**

(Në mungesë dhe me urdhër)

